

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Të përgjithshme.

- Fadroma do të përdoret kryesisht për pastrimin e rrugeve rurale dhe ngarkimin e materialeve për zhavorrimin e rrugëve në të gjithë territorin e bashkisë.
- Në ambjentin ku do të operojë, temperaturat mesatare mujore variojnë nga maksimumi 40 gradë Celsius në muajin korrik në minimum 0 gradë Celsius në muajin janar. Temperatura maksimale arrin në 45 gradë Celsius dhe minimalja mund të zbrese në -10 deri -15 gradë Celsius. Lagështia relative mesatare varion nga 25% në 80%. Rreshjet mesatare vjetore variojnë nga 850 mm (milimeter) në 1000 mm dhe rreth 80% e këtyre rreshjeve bien në muajt e dimrit në periudhën nëntor-mars.
- Fadroma duhet të jetë plotësisht e montuar me të gjitha pajisjet standarte normale, dhe e gatshme për të filluar punë të menjëhershme.
- Karakteristikat e sigurisë të sistemit të frenimit, drejtimit, ecjes, ndriçimit, dhe të gjitha pajisjet dhe aparatat duhet të jenë konform rregullave dhe standardeve të Bashkimit Europian.

Specifikime teknike kryesore të mjetit :

- Fadroma duhet të jetë e tipit gjysmëlevizese me shasi të artikulluar, hidraulik, me goma dhe me kovë ngarkuese .
- Marka e mjetit të jete CATERPILLAR, JCB, KOMATSU, FKI
- Mjeti të jete jo më i vjetër se viti 2004
- Peshë e mjetit duhet të jete 11000 kg – 13000 kg.
- Gjatesia e mjetit 4m-6m
- Mjeti të jete jo më shumë se 9000 ore pune
- Motorri të jete me naftë me ftohje me ujë, me fuqi jo më të vogël se 94 kw (kilovat)
- Motorri të jete në gjendje të mirë dhe të mos ketë rrjedhje vaji.
- Pjesët hidraulike të jenë pa rrjedhje
- Gabina duhet të jete konform rregullave të Bashkimit Europian, me sistem të ngrohjes dhe ftohjes etj
- Struktura e sipërme të jete e rrotullueshme në 180 gradë, në të dy drejtimet e rrotullimit
- Fadroma duhet të jete e pajisur me manualët e operimit dhe servisimit
- Gjendje e përgjithshme optimale pasqyruar me foto të mjetit, të ketë paraqitje të jashtme të rregullt
- Fadroma duhet të realizojë operimin e njëkohshëm të kovës, kthimin mjetas-djathtas të platformës së sipërme dhe mekanizmit të levizjes.

- Fadroma duhet te jete e paisur me nje kove per pastrimin e rrugeve me kapacitet rreth 1.8-2.5 m3 (meter kub)

Garancia dhe sherbimi i pas shitjes

- Fadroma duhet te jete e mbuluar me nje garanci teknike nje vit nga dita e lidhjes se kontrates.
- Ofertuesi duhet te konfirmoje nje servis i cili eshte operues ne territorin e Shqiperise duke dhene adresen ose adresat ku mund te kryhen sherbimet e pas shitjes. Ky servis do te jete pergjegjes per mbulimin e sherbimeve gjate periudhes se garancise (ne vendodhjen e fadromes) si dhe te kete mundesine e sigurimit te sherbimeve apo pjeseve te nderrimit edhe pas perfundimit te periudhes se garancise.
- Ofertuesi me shpenzimet e tij duhet te trajnoje ne nje periudhe prej 2 ditesh drejtuesin e mjetit per perdorimin e fadromes dhe sherbimet e perditshme.
- Periudha e levrimet maksimum 1 (nje) muaj nga dita e nenshkrimit te kontrates.
- Çmimi i fadromes perfshin dhe transportin deri ne objekt .



Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	Fadrome me goma	cope	1		
				SHUMA1	
				TVSH 20%	
				SHUMA 2	

Afatet e lëvrimit: Nga dita e lidhjes se kontrates me perfundim ne ditën e tridhjetë .

Open
Procurement
Albania